

VENDIM
Nr.607, datë 8.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.438, DATË 13.7.2007 “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, në pikën 1, lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË DHE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi
1	2	3	4
Bazë	Agjent	35 200	7 000
	Agjent i i-rë	38 300	7 000
	Asistent	40 950	8 000
	Asistent i i-rë	42 500	8 000
	Kryeasistent	45 000	8 000
I mesëm	Nëninspektor	49 000	6 000
	Inspektor	53 000	6 000
	Kryeinspektor	62 000	6 000
I lartë	Nënkomisar	71 000	6 000
	Komisar	82 000	6 000
	Kryekomisar	94 000	6 000
Madhor	Drejtues	105 000	
	Drejtues i I-rë	115 000	

